

ABSTRAKT

“Prostitucioni si qëllim i trafikimit me qenie njerëzore në territorin e Kosovës gjatë periudhës 2015-2019 ”.

Bashkangjitur kësaj kërkesë gjeni edhe:

- **Arsyeshmërinë e punimit të temës**
- **Metodologjia e punës**
- **Strukturën përkatësisht tezat e punimit**
- **Literaturën e shfrytëzuar gjatë punimit**
- **Akronimet si dhe**
- **Biografinë personale**

Arsyeshmëria e punimit të temës

Lidhur me zgjedhjen time për të trajtuar këtë tematikë, qëndrojnë disa arsye për të cilat edhe jam motivuar për ta trajtuar këtë tematikë.

Një nga arsyet të cilat më kanë shtyrë për të trajtuar këtë temë është fakti se prostitucioni si qëllim i trafikimit me qenie njerëzore, nuk është se trajtohet aq shumë në Republikën e Kosovës gjithashtu konsideroj se me rezultatet modeste dhe optimale të cilat do të arrihen nga ky punim do të mund që të kontribuojnë sa do pak në krijimin e një këndvështrimi tjetër , e të njëjtat rezultate sa do pak mund të përdoren sa do pak nga komuniteti juridik vendor për të përmirësuar dispozitat juridike ligjore lidhur me këtë çështje.

Gjithashtu ky punim mund të kontribuoj sa do pak edhe rasteve praktike që ndërlidhen me mbrojtjen e viktimave të trafikuar, si dhe trajtimi i prostitucionit si dukuri sociopatologjike që është një fenomen që ka nevojë zhvillimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, e vendor në çështjet penale.

Si qëllim edhe me i madh i këtij punimi është bashkëpunimi i institucioneve vendore krahas këtyre dukurive, pasi që prostitucioni si dukuri socio-patologjike dhe trafikimi me qenie njerëzore janë të trajtuara me shume nga organizatat e huaja, sesa ato vendore. Është e qartë se Kosova është një vend në tranzicion, dhe institucionet vendore mundohen që të kontribuojnë në drejtësinë në

mënyrë të duhur, por gjithsesi nevoja ekziston tek jetësimi i teorive dhe mjeteve të krahasimit kundër luftimit të trafikimit me qenie njerëzore dhe prostitucionit.

Arsyeja tjetër qëndron në faktin se me këtë punim synohet që të vihet në pah rëndësia e qenieve njerëzore, mënyra e aplikimit të rregullt të institucioneve drejt këtyre dukurive, me faktin se edhe pse këto dukuri janë mjaft të lashta, rëndësia e tyre qëndron në faktin se asnjë person nuk gëzon privilegjin që të mos gjykohej për një veprë penale të cilën e ka kryer e as të mbetet i pandëshkuar, gjithashtu edhe lëvizja e madhe e popullsisë e rrit domosdoshmërinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Gjykimi i kryerësve të krimit dhe ndëshkimi i atyre kryerësve të cilët shpallen fajtorë pa dyshim e forcon shtetin ligjor, ngase një nga premisat e shtetit ligjor është edhe lufta kundër kriminalitetit.

Edhe analizimi i kushteve dhe i procedurave lidhur me realizimin e bashkëpunimit të rendit të shtetit, e në veçanti lidhur me realizimin e specifikave të cekura më lart përmes këtij punimi, do të mundohet që lexuesve të këtij punimi t'u sjellë njohuri elementare, si dhe të i nxisë ata që të bëjnë kërkime dhe hulumtime të tjera profesionale përkitazi me këtë tematikë.

Metodologjia e punës

Për shkak se Kosova nuk ka eksperiencë të mjaftueshme për luftimin e këtyre dukurive, patjetër që tematika e këtij punimi duhet të vështrohet në aspekt më të gjerë interdisiplinor.

Fakti se tematika e këtij punimi është e gjerë se janë fenomene mjaft të lashta, avantazh i këtij punimi do të jetë që metodat me të cilat do të orientohet studimi dhe të cilat do të përdoren për qëllime të studimit të këtij punimi nuk do të përcaktohen nga filli, por ato do të dalin në kontinuitet me elaborimet që do të dalin çoftë gjatë studimit të aspektit teorik të tematikës, apo edhe të rasteve konkrete,

Pa marrë parasysh se objekti i tematikës së këtij punimi e determinon edhe metodologjinë, do të kem parasysh faktin se do të bëjë përpjekje që metodat e përdorura t'ia përshtati objektit të studimit, në mënyrë që studimi të bëhet në mënyrë të mirëfilltë dhe punim të dalë sa më i pasur me njohuri.

Disa nga metodat të cilat do të përdoren për qëllime të këtij punimi janë: metoda normative, metoda komparative, metoda dogmatike-juridike, metoda e analizës dhe e sintezës, metoda statistikore si dhe metoda tjera të cilat mund të implementohen në shkencën e të drejtës penale.

PËRMBAJTJA

PJESA HYRËSE

1. Objekti dhe arsyet e studimit
2. Metodatat e studimit
3. Struktura e punimit

KAPITULLI I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME HISTORIKUN E PROSTITUCIONIT DHE TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE

1. Historiku i prostitucionit dhe trafikimit me qenie njerëzore..... 6
2. Përkufizimi i prostitucionit..... 12
3. Tregtia me femra për shkaqe seksuale..... 14
4. Format e prostitucionit..... 14
 - 4.1 Prostitucioni në shtëpitë legale publike..... 16
 - 4.2 Prostitucioni ushtarak 16
 - 4.3 Prostitucioni në rrugë..... 17
 - 4.4 Prostitucioni në vitrinë..... 19

KAPITULLI II

RËNDËSIA E KORNIZËS LIGJORE VENDORE DHE NDËRKOMBETARE LIDHUR ME PROSTITUCIONIN DHE TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE ME QËLLIM PROSTITUCIONI

2. Historiku i zhvillimit të bazës ligjore mbi prostitucionin si qëllim i trafikimit me qenie njerëzore në rrafshin ndërkombëtar20
3. Rregullimi penalo-juridik për prostitucionin dhe trafikimin me qenie njerëzore26
4. Të drejtat dhe detyrimet e viktimave të prostitucionit29

5.	Të drejtat dhe detyrimet e përfituesve të shërbimeve të prostitucionit	31
----	------------------------------------------------------------------------------	----

KAPITULLI III

PROSTITUCIONI NË ASPEKT SOCIO-EKONOMIK DHE PASOJAT SOCIO-PATOLOGJIKE TEK VIKTIMAT

3.	Ndikimi i faktorëve ekonomiko-social në dukurinë e prostitucionit	33
4.	Rreziqet e prostitucionit ilegal dhe përfitimet e prostitucionit legal.....	36
5.	Prostitucioni dhe pasojat sociopatologjike tek viktimat.....	37

KAPITULLI IV

ETIOLOGJIA E TRAFIKIMIT ME NJERËZ ME QËLLIM TË SHFRYTËZIMIT TË VIKTIMAVE PËR PROSTITUCION NË KOSOVË PËR PERIUdhËN 2015-2019

5.	Vëllimi dhe dinamika e trafikimit me qenie njerëzore me qëllim prostitucioni në Kosovë	44
6.	Faktorët që ndikojnë në prostitucionin si qëllim i trafikimit me njerëz sipas vendimeve të Gjykatave Themelore në Kosovë	46
7.	Karakteristikat dhe identifikimi i kryesëve dhe viktimave të trafikimit me njerëz për qëllim prostitucioni	47

KAPITULLI V

MASAT PËR PARANDALIMIN E PROSTITUCIONIT SI DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE

6.	Ndjekja penale e trafikuesve me njerëz, me qëllim prostitucioni sipas legjislacionit të Kosovës	49
7.	Ndihma dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore me qëllim prostitucio	52
	Rehabilitimi dhe ri integrimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore	

PËRFUNDIMET DHE KONKLuzionET

LITERATURA:

1)Libra dhe artikuj

Salihu Ismet, Zhitija Hilmi, Hasani Fejzullah, Komentar, Mars 2014, Prishtinë

Salihu Ismet, *E drejta penale*, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, 2003
Latifi, Vesel, Demolli Haki, *Kriminalitstika*, Prishtinë, 2019
Halili, Ragip, *Penologjia*, Prishtinë, 2014
Halili, Ragip, *Kriminologjia*, Prishtinë, 2016
Sahiti Ejup, Murati Rexhep, *E drejta e procedurës penale*, Prishtinë, 2016
Gruda, Zejnullah, *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut*, Prishtinë, 2010
Sadikaj, Beqir, “Trafikimi i femrave në Kosovë me qëllim prostitucioni, si formë e krimin të organizuar“, “E drejta “ nr. 4/2002 Prishtinë
Hasani, Shefkije, *Fjalor i terminologjisë juridike*, Prishtinë 1998

2)Kushtetuta dhe ligje

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008
Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave nga trafikimi, Nr. 04/L-218, 31 Korrik 2013
Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 19, 13 korrik 2012
Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nr. 06/L-074, 14 janar 2019
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal të Kosovës, Nr. 04/L-082
Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosoves, 04/L-123, 28 dhjetor, 2012
Rregullore nr. 2001/4 Mbi ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë, 12 Janar 2001

3)Dokumente ndërkombëtare

International Convention for te Supression of the White Slave Traffic, 4 May 1910, III LNTS 278.
Convention for the Suppression of the Traffic in Persons and of the Exploitation of the Prostitution Others, in force since 25 July 1951, 96 UNTS 271
Council of Europe, The Europe Convention on Human Rights, 20 Janar 1966, In Strabourg
Budapest Declaration on Public Health & trafficking in Human Beings, 19 - 21 March 2003, in Budapest
Konventa e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Këshilli i Evropës, Varshavë, 16.05.2005, Seria e Traktateve Evropiane ETS, nr. 197

4)Burime nga interneti dhe burime të tjera

Human Trafficking, Human Misery: The Global Trade in Human Beings. Contributors: Alexis A. Aronowitz - Author. Publisher: Praeger. Place of publication: Santa Barbara, CA. Publication year: 2009.

Human Trafficking to Human Rights: Reframing Contemporary Slavery. Contributors: Alison Brysk - Editor, Austin Choi-Fitzpatrick - Editor. Publisher: University of Pennsylvania Press. Place of publication: Philadelphia.

<https://rm.coe.int/168064544c>

<https://web.archive.org/web/20071013123632/http://web.amnesty.org/actforwomen/stories-9-eng>

<https://juridiku.uni-pr.edu/getattachment/Revista--E-Drejta-/7-Emine-Abdyli-B5--147---170.pdf.aspx>

https://publications.iom.int/system/files/pdf/legal_framework_albanian.pdf?language=en

<https://www.osce.org/>

Akronimet:

KPP – Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

KPK – Kodi Penal i Republikës së Kosovës

KK – Kushtetuta e Republikës së Kosovës

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Biografia Personale

Jam lindur më 1 shkurt 1996 në Garmisch-Paternkirchen, Gjermani. Jam shtetase e Republikës së Kosovës. Shkollimin fillor, të mesëm dhe atë universitar e kam përfunduar në qytetin e Gjilanit, përkatësisht me studime bachelor i kam vijuar në vitin 2014, në fakultetin Juridik në Universitetin “Kadri Zeka” në Gjilan, ku kam qenë bursiste e këtij universiteti tri vite me radhë, pra viti i fundit ka qene nje stagnim i një maratone 3 vjecare, ku kam qenë e angazhuar me punë studentore, praktikë dhe paralelisht studente. Kam përfituar njohuri të përgjithshme nga këto, por jo edhe një bursë të fundit për shkak të uljes së notës mesatare.

Studimet në nivelin bachelor i kam përfunduar në vitin 2018 , me notë mesatare 8.95.

Në tetor të vitit 2019 kam regjistruar studimet postdiplomike-master, në programin penal, në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe në shtator të vitit 2020 kam përfunduar të gjitha provimet e parapara me notën 9.30.

Nga data 4 shkurt 2019-2020 vijoj praktikën profesionale tek avokati Dren Salihu, Prishtinë.

Momentalisht po studioj, punoj dhe ndjekë trajnime për parapërgatitje të provimit të jurisprudencës, të cilin e konsideroj objektiv të rradhës.